



VENDIMI ËSHTË I PLOTFUQISHËM  
ODLUKA JE PRAVNOSNAŽNA  
GJYKATA THEMELORE / OSNOVNI SUD  
FERIZAJ I UROŠEVAC



Më  
Dana

10-09-2018

REPUBLIKA E KOSOVËS  
REPUBLIKA KOSOVA - REPUBLIC OF KOSOVO  
GJYKATA THEMELORE FERIZAJ

Numri i lëndës: 2018:011705  
Datë: 18.04.2018  
Numri i dokumentit: 00026352

P nr.1510/17

NË EMËR TË POPULLIT

GJYKATA THEMELORE NË FERIZAJ - Departamenti i Përgjithshëm, Divizioni Penal, në përbërje nga gjyqtari individual Elmaz Zenuni dhe sekretares juridike Ibadete Qerimi, në çështjen penale kundër të akuzuarës [REDACTED] nga Ferizaji, Rruga [REDACTED] ndërtesa [REDACTED] Hyrja [REDACTED] Kati i [REDACTED] banesa nr. [REDACTED], për shkak të veprës penale uzurpimi i paligjshëm i pronës së pa luajtshme nga neni 332 par.2 nënpar.2.2 të KPRK-së, sipas aktakuzës ë Prokurorisë Themelore në Ferizaj PP/II nr.1013-3/2017 të dt.19.06.2017, pas mbajtjes së shqyrtimit fillestar gjyqësor publik me dt.18.04.2018, në praninë e përfaqësuesit të akuzës prokurorit të shtetit Valdet Avdiu dhe të akuzuarës, të njëjtën ditë mori dhe publikisht komunikoi, ndërkaq me datën 19.04.2018 përpiloi këtë:

AKTGJYKIM

I akuzuari, [REDACTED] nga Ferizaji, Rruga [REDACTED] ndërtesa [REDACTED] Hyrja [REDACTED] Kati i [REDACTED] banesa nr. [REDACTED] e lindur me [REDACTED] në Ferizaj nga i ati [REDACTED] dhe e ëma [REDACTED], e vajzërisë [REDACTED], profesoreshë e historisë, e martuar nbënë e 2 (dy) fëmijëve, ka të

kryer Fakultetin e historisë, punon në Qendrën e Studentëve në Prishtinë si Bibliotekiste, e gjendjes së mesme ekonomike, posedon nr.personal [REDAKTUAR] shqiptare, shtetase e Republikës së Kosovës, mbrohet në liri,-

### ËSHTË FAJTORE

Sepse që nga paslufta e deri në 22 maj 2017 e në vijim edhe më tutje në Ferizaj në Rrugën [REDAKTUAR] ndërtesa [REDAKTUAR] Hyrja [REDAKTUAR] Kati i [REDAKTUAR] banesa nr [REDAKTUAR] e pandehura në mënyrë të kundërligjshme ka uzurpuar pronën e pa lujatshme –banesën me sipërfaqe 64.7 metra katror e cila është pronë e të dëmtuarit [REDAKTUAR] i cili të njëjtën banesë të sipërtheksuar e ka blerë me datën 03 nëntor 2016 nga pronarja [REDAKTUAR] -

**Me këtë ka kryer veprën penale uzurpimi i paligjshëm i pronës së pa lujatshme nga neni 332 par.2 nënpar.2.2 të KPRK-së .**

Andaj, Gjykata, në kuptim të nenit 332 par.2.1. të KPRK-së, dhe neneve: 3, 7, 17, 23, 41, 9, 50, 51, 55, 73 të KPRK-së, si dhe nenit 365 të KPPRK-së, të pandehurën e:

### GJYKON DËNIM ME KUSHT

**I VËRTETOHET** dënimi me burgim në kohëzgjatje prej 3 /tre/ muajve, i cili dënim nuk do të ekzekutohet brenda periudhës së verifikimit prej 1 viti. Dënimi i shqiptuar është dënim me kusht i kushtëzuar me lirimin e pronës, ashtu që Obligohet e pandehura që pronën e palujatshme banesën e cila gjendet në Ferizaj në Rrugën [REDAKTUAR] ndërtesa [REDAKTUAR] Hyrja [REDAKTUAR] Kati i [REDAKTUAR] banesa nr [REDAKTUAR] sipas ngastra kadastrale Çertifikata mbi të drejtat e pronësisë me nr.108996/2016 dhe atë Kopje të Planit O-72217092-02188-1-155-2-9-0 në vendin e quajtur në Ferizaj në Rrugën [REDAKTUAR] ndërtesa [REDAKTUAR] Hyrja [REDAKTUAR] Kati i [REDAKTUAR] banesa nr [REDAKTUAR] sipërfaqja 64.7 metra katror të Drejtoratit për Pronë, Gjeodezi dhe Kadastër-Zyra Kadastrale në Ferizaj ta liroj nga njerëzit dhe sendet dhe të i dorëzohet të dëmtuarit [REDAKTUAR] nga Ferizaji, Rruga [REDAKTUAR] pa nr, në posedim dhe atë në afat prej 6 (gjashtë) muajve nga dita kur aktgjykimi të merr formën e prerë, nën kërcënimin e ekzekutimit me dhunë.

Konform nenit 55 të KPRK-së, nëse i pandehuri nuk e përmbush detyrimin e paraparë me nenin 51 par. 3 të KPRK-së, të përshkruar më lartë në dispozitivin e këtij aktgjykimi, denimi me kusht do të i revokohet dhe do të i shëndrrohet në denim me burg.

Konform nenit 463 par. 1 të KPPRK-së, si dhe nenit 464 të KPPRK-së, aprovohet kërkesa pasuroro-juridike e të dëmtuarit [REDAKTUAR] nga Ferizaji, Rruga [REDAKTUAR] pa nr. sa i përket lirimit dhe dorëzimit të pronës së paluajtshme të përshkruar më lartë në dispozitivin e këtij aktgjykimi, ndërsa sa i përket pjesës tjetër të kërkesës për realizimin e kompensimit të dëmit udhëzohet në kontest civil.

Obligohet e pandehura që në emër të shpenzimeve të paushallit gjyqësor të paguan shumën prej 20 € në afat prej 15 ditëve, nga data kur aktgjykimi të marrë formën e prerë, nën kërcënimin e përmbarrimit të dhunshëm.

Konform nenit 39 par.3.1 të Ligjit për Kompensimin e Viktimave të Krimit –Ligji nr.05/L-036, Obligohet e akuzuara që në emër të Taksës për Kompensimin e Viktimave të Krimit të paguaj shumën prej 30 eurove, në afat prej 15 ditëve, nën kërcënimin e përmbarrimit të dhunshëm.

### **A r s y e t i m i**

Prokuroria Themelore në Ferizaj me aktakuzë PP/II nr.1013-3/17 të dt.19.06.2017, e ka ngarkuar të pandehurën, [REDAKTUAR] nga Ferizaji, Rruga [REDAKTUAR] ndërtesa [REDAKTUAR] Hyrja [REDAKTUAR] Kati [REDAKTUAR] banesa nr. [REDAKTUAR] për shkak të veprës penale uzurpimi i paligjshëm i pronës së paluajtshme nga neni 332 par.2 nënpar.2.2 të KPRK-së.

Gjykata, duke vepruar sipas aktakuzës së PTH-së në Ferizaj, me datën 18.04.2018, mbajti shqyrtimin fillestar ku prezentuan prokurori i shtetit Valdet Avdiu, e pandehura, kurëse përfaqësuesi i të dëmtuarit: [REDAKTUAR] nga Ferizaji nuk prezentoi pasi që në shqyrtim fillestar, nuk kërkohet prezenca e tij sipas ligjit.

Konform nenit 246 të KPPRK-së të pandehurës pasi që i janë dhënë udhëzimet nga ana e gjyqtarit gjatë shqyrtimit fillestar përkitazi me pranimin e fajsisë, e akuzuara e ka pranuar fajësinë sipas aktakuzës për veprën penale që e ngarkon prokurori i shtetit.

Në vlerësimin e pranimin të fajsisë së të pandehurës gjyqtari gjykues konform nenit 248 par.2 të KPPRK-së ka kërkuar edhe mendimin e prokurorit të shtetit përkitazi me pranimin e fajsisë nga ana e të akuzuarës, ashtu që prokurori i shtetit është pajtuar me pranimin e fajsisë nga ana e të akuzuarës të cilët kanë deklaruar se mundë të shkohet me shqiptimin e dënimit.

Gjyqtari gjykues ka vlerësuar se kërkesat nga neni 248 paragrafi 1 i KPPRK-së janë përmbushur, pasi që:

- E pandehura ka kuptuar natyrën dhe pasojat e pranimin të fajsisë,
- Pranimi është bërë vullnetarisht.
- Pranimi mbështetet në prova dhe fakte të çështjes penale që përmban aktakuza dhe materialet e prezentuara nga ana e prokurorit të shtetit me aktakuzë dhe atë: Çertifikata mbi të drejtat e pronësisë me nr.108996/2016 dhe atë Kopje të Planit O-72217092-02188-1-155-2-9-0 në vendin e quajtur në Ferizaj në Rrugën "██████████" ndërtesa "Hyrja" Kati i ██████ banesa nr. █████ sipërfaqja 64.7 metra katror të Drejtoratit për Pronë, Gjeodezi dhe Kadastër-Zyra Kadastrale në Ferizaj, Kontrata e shitblerjes së palujtshmërisë-banesës në emër të dëmtuarit ██████████ me nr.1533/2016 e dt.28.10.2016, si dhe fotot të cilat janë pjesë përbërëse e shkresave të lëndës,
- akuza nuk përmban asnjë shkelje ligjore ose gabime faktike, njashtu i akuzuari është udhëzuar nga ana e Gjyqtarit gjykues edhe konform nenit 383 par.2 të KPPRK-së, përkitazi me të drejtën e ankesës vetëm për sanksionin penal, por jo edhe për shkak të gjendjes faktike, si dhe
- Konform nenit 257 të KPPRK-së, aktakuza nuk ka prova të pa pranueshme.

E akuzuara ██████████, në shqyrtimin fillestar në mbrojtjen e saj në kuptim të mbrojtjes ka deklaruar, pasi e ka pranuar fajësinë lidhur me veprën penale që e ngarkon prokuroria është penduar thellë për atë që e ka kryer, por nuk ka pasur ku të srehohet, ka pasur për qëllim që ta blej banesën, por nuk ka mundur ta kontaktoj pronaren e banesës, ka dyshime në dokumentacionin valid të shitblerjes së kësaj banese nga blerësi, nuk ka ku të strehohet dhe

ka dy fëmijë pa zgjidhje të problemit të banimit, ka premtuar se në të ardhmen kurr nuk do të përsëris vepër penale dhe i ka propozuar gjykatës që me rastin e matjes së dënimit si rrethana lehtësuese ti ketë theksësimet e sipër theksuara.

Vlerësuar nga aspekti juridik gjykata gjeti se në veprimet e të pandehurit kanë ekzistuar të gjitha tiparet objektive dhe subjektive të cilat e përbëjnë figurën e veprës penale uzurpimi i paligjshëm i pronës së paluajtshme nga neni 332 par.2 nënpar.2.1 të KPRK-së .

*( Nëse i pandehuri në shqyrtimin fillestar pranon fajësinë dhe Kryetari i trupit gjykues vlerëson se pranimi i fajit është bërë në pajtim me ligjin mund të vazhdoj procesin me shqiptimin e dënimit duke mos administruar fare prov, pa plotësuar trupin gjykues dhe pa e mbajtur fare shqyrtimin gjyqësor, si dhe pa paraqitur fare fjalë përfundimtare, lidhur me këtë shih Mendimin Juridik të Gjykatës Supreme të Republikës së Kosovës të evidentuar si GJA.nr.207/13 të dt.19.03.2013).*

Me rastin e matjes së llojit dhe lartësisë së dënimit gjykata pati parasyshë të gjitha rrethanat në kuptim të nenit 73 të KPRK-së të cilat ndikojnë në llojin dhe lartësinë e dënimit, si rrethana lehtësuese mori se e pandehura ka pranuar fajsinë në shqyrtimin fillestar gjyqësor, nuk ka të dhëna se me herët të ketë qenë e dënuar me aktgjykim të formës së prerë për vepra penale, pendesën për veprën e kryer, ka kërkuar falje për veprimet e ndërmmarrura dhe se nuk ka qenë në gjendje ta siguroj shitësin me qëllim të blerjes së banesës, ka premtuar se në afat ate do ta liroj, është e martuar nënë e 2 fëmijëve të cilët varen nga puna e saj, duke qenë e bindur se në rastin konkret qëllimi i dënimit mund të arrihet, dhe një dënimi i tillë është në proporcion me peshën e veprës penale, shkallën e përgjegjësisë penale të pandehurës dhe rrethanave të kryerjes.

Mbi bazën e këtyre rrethanave gjykata vlerësoi shkallën e përgjegjësisë penale të pandehurës, dhe rrezikshmerinë konkrete të veprës penale në kuptim të gjitha këtyre rrethanave duke i caktuar dënim të kushtëzuar. Gjykata të pandehurit i shqiptoj një dënim të kushtëzuar duke marrë parasysh shkallën e përgjegjësisë penale, rrethanave të kryerjes së veprës nga neni 51 i KPRK-së, me të cilin dënim do të arrihet qëllimi ndëshkimor në kuptim të preventivës speciale dhe asaj gjenerale i paraparë me nenit 41 të KPRK-së.

Konform nenit 55 të KPRK-së, nëse i pandehuri nuk e përmbush detyrimin e paraparë me nenin 51 par. 3 të KPRK-së, të përshkruar më lartë në dispozitivin e këtij aktgjykimi, denimi me kusht do të i revokohet dhe do të i shëndrrohet në denim me burg.

Konform nenit 463 par. 1 të KPPRK-së, si dhe nenit 464 të KPPRK-së, aprovohet kërkesa pasuroro-juridike e të dëmtuarit [REDAKTUAR] nga Ferizaji, Rruga [REDAKTUAR] pa nr. sa i përket lirimit dhe dorëzimit të pronës së paluajtshme të përshkruar më lartë në dispozitivin e këtij aktgjykimi, ndërsa sa i përket pjesës tjetër të kërkesës për realizimin e kompensimit të dëmit udhëzohet në kontest civil.

Mbështetur në nenin 450 dhe 451 të KPPK-së obligohet i pandehuri që në emër të shpenzimeve të paushallin gjyqësor në lartësi prej 20 €, i cili është caktuar duke pasur parasysh gjendjen ekonomike të të akuzuarit, dhe çështjen penale të zhvilluar.

Konform nenit 39 par.3.1 të Ligjit për Kompensimin e Viktimave të Krimit –Ligji nr.05/L-036, Obligohet i akuzuari që në emër të Taksës për Kompensimin e Viktimave të Krimit të paguaj shumën prej 30 eurove, në afat prej 15 ditëve, nën kërcënimin e përmbarrimit të dhunshëm.


Nga sa u theksua ma lart gjykata vendosi si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

### GJYKATA THEMELORE NË FERIZAJ,

P nr.1510/2017 të dt.18.04.2018

Sekretarja juridike,  
Ibadete Qerimi

Gjyqtari

Elmaz Zenuni  


#### KËSHILLA JURIDIKE:

Kundër këtij aktgjykimi lejohet ankesa në afat prej 15 ditëve, nga dita e pranimit të këtij aktgjykimi Gjykates së Apelit në Prishtinë, ankesa dorëzohet nëpërmes kësaj gjykate.

Nga një kopje e aktgjykimit iu dërgohet të dëmtuarit [REDAKTUAR] nga Ferizaji, Rruga [REDAKTUAR] pa nr.